

VENDIM
Nr. 67, datë 25.10.2016

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR DHËNIEN E NDIHMË DE MINIMIS

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|---------------------|----------|
| - | Znj. Milva Ekonomi | kryetar; |
| - | Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtar; |
| - | Z. Ahmet Mançellari | anëtar; |
| - | Z. Petrit Bakiu | anëtar; |
| - | Z. Gramoz Hoxha | anëtar. |

Në mbështetje të nenit 8, 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “*De Minimis*”,

VËREN SE:

1. Pika 1, e kreut IX, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “*De Minimis*”, parashikon se:

“Dhënësi i ndihmës “De minimis” i kërkon ndërmarrjes një deklaratë mbi çdo ndihmë “de minimis” të përfutur gjatë dy viteve të kaluara dhe vitit financiar në vazhdim. Ndërmarrja përfituese e ndihmës nënshkruan deklaratën, sipas modelit të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.”

2. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ngarkohet të miratoj modelin e deklaratës që duhet nënshkruar nga përfituesi i ndihmës *de minimis*.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Miratimin e deklaratës për dhënien e ndihmës *De Minimis*, sipas modelit bashkëngjitur këtij vendimi.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

DEKLARATË

NDIHMA SHTETËRORE *DE MINIMIS*

Unë, lindur më _____, me vendbanim _____, në cilësimë e përfaqësuesit ligjor të ndërmarrjes/shoqërisë tregtare _____, me NIPT _____, me seli në _____,

në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*".

DEKLAROJ SE:

1. Ndërmarrja, që përfaqësoj:

- ☐ Nuk është e kontrolluar nga, apo nuk kontrollon, direkt ose indirekt, ndërmarrje të tjera;
☐ Kontrollon, qoftë edhe indirekt, ndërmarrjet e tjera me seli në territorin e Shqipërisë;

☐ Është e kontrolluar, qoftë dhe indirekt, nga ndërmarrje të tjera me seli në territorin e Shqipërisë;

2. Ndërmarrja, që përfaqësoj, gjatë këtij vit financiar apo dy viteve të mëparshme:

- ☐ Ka qenë objekt, bashkimi me ndërmarrje tjetër apo ndarje, në dy apo më shumë ndërmarrje;
☐ Nuk ka qenë objekt, bashkimi me ndërmarrje tjetër apo ndarje në dy apo më shumë ndërmarrje.

3. Deklaroj se ndërmarrja, që përfaqësoj:

☐ Nuk ka përfituar ndihmë *De Minimis*, bazuar në vendimin e K.M-së nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*";

☐ Ka përfituar ndihmë *De Minimis*, bazuar në vendimin e K.M-së nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*", si më poshtë:

Ndërmarrja përfituese ¹	Baza ligjore	Data e dhënies së ndihmës	Dhënësi i ndihmës	Shuma bruto

Unë deklaroj se shuma e përgjithshme e ndihmës *De Minimis* përfituar nga ndërmarrja _____ gjatë tre viteve të njëpasnjëshme financiare është:

Viti 1 () ALL	Viti 2 () ALL	Viti 3 () ALL	Total ALL

Ndërmarrja

Emri

Pozicioni

Data

Nënshkrimi

¹ Në rast bashkimi apo ndarje të ndërmarrjeve duhet të tregohet ndërmarrja që ka përfituar ndihmë.

